



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AKK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që

cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në respektimin e rregullave financiare në realizimin e pagesave.

Raporti i auditimit ka rezultuar me dy (2) rekomandime të reja. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 77,000€, prej tyre ishin shpenzuar 52,577€.

Çështja A1 - Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjës pas pranimit të faturës

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, në nenin 15, përcakton që procedurat e blerjes duhet të fillojnë me një kërkesë për blerje, pastaj zotimi i mjeteve, pas të cilës duhet të procedohet me urdhër blerje, pranimin e mallit ose shërbimit, shpenzimi dhe më në fund pagesën e faturës.

Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në tre (3) raste në vlerë totale 433€, zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet ishin proceduar pasi kishte ardhur fatura.

Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave mund të shkaktojë ndikim të mos kryerjes së obligimeve faturuara në kohë, duke çuar në rritjen e detyrimeve të papaguara, që në fund do të shkaktojnë probleme për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi A1 Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës duhet të sigurohet që, zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Pjesëmarrja e këshilltarit të jashtëm në udhëtime jashtë vendit

Gjetja Neni 4 pika 1 i rregullores (QRK) Nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzimet e Përfaqësimit përcakton që: Zyrtarët publik, funksionarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga buxheti i shtetit kanë të drejtë të kompensohen për shpenzimet e kryera për udhëtime dhe për qëndrim zyrtar jashtë vendit.

Kryetarja e AKK-së kishte marrë vendime që pjesë e delegacioneve për udhëtime zyrtare të jetë edhe një person në cilësinë e Këshilltarit të Jashtëm të Kryetares dhe të Drejtorit të përgjithshëm të Sekretariatit të AKK-së.

Ky person në cilësinë e ekspertit kishte tri marrëveshje afatshkurtëra me ZKM me qëllim angazhimi në Autoritetin Kosovare të Konkurrencës, që për objektiv kishte kryesisht – Asistencë teknike në draftimin e rregulloreve të AKK-së bazuar në ligjin e ri të konkurrencës dhe EU aquis. Pjesëmarrja e tij në tri udhëtimet zyrtare nuk përkon me kohën e angazhimeve të tij si dhe me temat apo qëllimet e këtyre udhëtimeve.[5]

Shpenzimet e akomodimit dhe të biletave të këtij eksperti, AKK-së i kanë kushtuar 2,734€. Për më tepër mungonte një marrëveshje e bashkëpunimit në mes të AKK-së dhe ZKM-së.

Mbulimi i shpenzimeve për këtë person ishte për shkak të njohurive të tij në fushën e konkurrencës si dhe ofrimit të mundësive në rritjen e bashkëpunimit të AKK-së me institucionet relevante në arenën ndërkombëtare.

Ndikimi

Marrja e vendimeve të tilla mund të ndikojë në realizimin e shpenzimeve të paplanifikuara.

Rekomandimi A2

Kryetarja e AKK-së duhet të siguroj menaxhim efikas dhe racional të parasë publike si dhe zbatueshmëri të legjislacionit gjatë realizimit të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ⁶ | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|-----------------------------|-------------------|----------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| Burimet e fondeve | 393,868 | 312,377 | 286,880 | 257,857 | 244,365 |
| Grante Qeveritare – Buxheti | 393,868 | 312,377 | 286,880 | 257,857 | 244,365 |

Buxheti final është më i ulët në raport me buxhetin fillestar për 81,491€.

Në vitin 2023, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 286,880€, me një rritje prej 11% krahasuar me shpenzimet e vitit 2022.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|--|-------------------|----------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 393,868 | 312,377 | 286,880 | 257,857 | 244,365 |
| Pagat dhe mëditjet | 314,868 | 233,377 | 233,377 | 200,734 | 201,032 |
| Mallrat dhe shërbimet | 77,000 | 77,000 | 52,577 | 56,199 | 42,419 |
| Komunalitë | 2,000 | 2,000 | 925 | 924 | 915 |


Shpjegimet për ndryshimet në kategorinë e buxhetit janë dhënë si më poshtë:

-Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 233,377€ dhe është më i ulët se ai fillestar për 81,491€. Buxheti në këtë kategori të shpenzimeve është zvogëluar me vendim të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Shpenzimet në këtë kategori ishin të njëjta me buxhetin final.

-Buxheti final për mallra dhe shërbime është i njëjtë me atë fillestar, në vlerë: 77,000€ nga të cilat 68% janë shpenzuar gjatë vitit.

-Buxheti final për shërbimet komunale krahasuar me atë fillestar nuk kishte ndryshime, i cili ishte në vlerë 2,000€. Në këtë kategori është shpenzuar 46% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga AKK për vitin 2023 ishin në vlerë 178,700€.

Të hyrat në vlerë 178,700€ janë realizuar nga taksat, kjo rritje është ndikuar në emër të njoftimit dhe vendimit për përqendrim të ndërmarrjeve ekonomike. Kjo rritje e të hyrave nga taksat e përqëndrimit ka ardhur si pasojë e rritjes së kërkesave nga ndërmarrjet ekonomike lidhur ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të tërësisë ose pjesëve të ndërmarrjeve.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|---------------|----------------|---------------|---------------|
| Totali i të hyrave | 19,476 | 19,476 | 178,700 | 25,300 | 7,025 |
| Të hyrat jo tatimore | 19,476 | 19,476 | 178,700 | 25,300 | 7,025 |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i Auditimit për PFV-të e vitit 2022 të AKK-së ka rezultuar me një rekomandim. AKK kishte paraqitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do ta zbatoj rekomandimin e dhënë. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, ishte zbatuar rekomandimi.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|--------------------|---|--------------------------------------|-----------|
| 1. | Pagat dhe mëditjet | Ne rekomandojmë menaxhmentin që të sigurojnë që në një kohë sa më të arsyeshme/afërt të zhvillojë procedurat konform kërkesave ligjore për plotësimin e pozitave udhëheqëse që mbahen me ushtrues detyre. | Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | I zbatuar |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

| Çështja | Komenti i OB-së | Pikëpamja e ZKA-së |
|--|---|---|
| Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjës pas pranimit të faturës | <p>Ne jemi të vetëdijshëm se duhet bërë zotimin dhe duhet nxjerrë urdhër blerjen para pranimit të faturës, sepse kështu e ka përcaktuar Rregullorja. Jane disa fatura që nuk e dimë sa do ta kenë shumen pa pranimin e tyre. P.sh. Fatura e derivateve të veturave! Zoton 500.00€, nxjerrë urdhër blerjen dhe vjen fatura 600.00C.</p> <p>Në këtë rast kotë është bërë zotimi, gjithashtu kotë është nxjerrë edhe urdhër blerja. Duhet anuluar zotimin dhe urdhër blerjen, për të bërë zotimin e ri në shumë 600.00€. Prap bëhet shkelje, sepse bëhet zotimi i ri dhe nxirret urdhër blerja e re, me faturë të pranuar. Por nëse ke zotuar 900.00€, këto 300.00€ nuk mund të përdoren më.</p> <p>Të nderuar, krejt kjo bëhet në funksion të kursimit të buxhetin, në funksion të shfrytëzimit sa ma racional, për faktin se buxheti i AKRK-së në mallëra dhe shërbime është i vogël, për të mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme.</p> | E gjetura qëndron – OB është pajtuar më gjetjen, dhe nuk ka ofruar dëshmi relevante për modifikimin e çështjes. |
| Pjesëmarrja e këshilltarit të jashtëm në udhëtime jashtë vendit | Ne konsiderojmë që e gjetura nuk qëndron. Kriteri i vendosur në gjetje nuk konsiston me gjendjen e përshkruar. Nëse bazohemi në ligjin 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 14, pika 4 përcakton se nëse eprori e shet të srsyeshme mund të autorizoj pjesmarrjen e këshilltarit të jashtëm në ndonjë udhëtim zyrtar | Këto janë arsyet e Organizatës Buxhetore. Dëshmi nuk kemi pranuar. Gjetja qëndron. |

| | | |
|--|---|--|
| | <p>jashtë vendit dhe me këtë rast shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen do të mbulohen nga buxheti i institucionit.</p> <p>Gjithashtu ju informojmë që rregullorja Nr. 06/2023 është nxjerr dhe bazuar edhe ne ligjin e cekur me larte përkatsisht ne nenin 8 paragrafi 4 nen paragrafi 4.5, Rregullorja për udhëtime zyrtare 06/2023 zbatohet edhe per institucionet e pavarura ne rastin tone për Autoritetin e Konkurrencës.</p> <p>Këshilltari ose ekspertit i apostrofuat në këtë çështje kishte kontratë përmes Zyrës se Kryeministrit për te përkrahur Autoritetin e Konkurrencës. Duke pas parasysh pervojen e gjatë të këshilltarit (ekspertit) në fjalë, Kryetarja e Autoritetit ka vendosur te përfshijë këshilltarin ose ekspertin në ekipin e saj ne udhëtimet zyrtare. Eksperti në forma të ndryshme ka qenë i angazhuar për të kryer punë për Autoritetin që nga viti 2014, dhe duke pasur parasysh reputacionin e mirë të tij në vendet e BE-së edhe kjo është një arsye shtesë që e kemi përfshirë në ekipin tonë për bashkëpunim ndërkombëtar.</p> <p>Përfaqësimi i Autoritetit është e paraparë edhe me rregullative ligjore në fuqi, ku sipas nenit 25, paragrafi 1, nënparagradi 1.1, Neni 65 të Ligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës.</p> | |
|--|---|--|



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me draft raportin e
Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023 dhe
për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit të Konkurrencës, për vitin 2023 dhe
- Pajtohem pjesërisht me gjetjen dhe rekomandimin të çështja A1 dhe nuk pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin të çështja A2, si dhe kam komente në përmbajtjen e Raportit për çështjet A1 dhe A2.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afazet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Autoriteti i Konkurrencës
Kryetarja


Neime Binaku-Isdij

Prishtinë, 20.06.2024.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikrat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ · Udhëtimi i realizuar në periudhën 19-24 qershor 2023 në Republikën Çeke, me temën ‘Vizite studimore për mbrojtjen e konkurrencës, përderisa kontrata e ekspertit mbulonte periudhën 29 maj deri 10 qershor 2023; · Udhëtimi i realizuar në periudhën 10-16 shtator 2023 në Trier të Gjermanisë, me temën “Kursi veror mbi të drejtën evropiane të prokurimeve publike” si dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Akademisë Evropiane të Drejtësisë (ERA) dhe AKK-së, përderisa kontrata e ekspertit mbulonte periudhën nëntor-dhjetor 2023; · Si dhe, udhëtimi i realizuar me 07 tetor 2022 në Trier të Gjermanisë, kontrata e ekspertit ishte nga nëntori 2022 deri janar 2023.
- ⁶ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikrat e mira.